



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË  
KRYETARI**

*Tiranë, më 16 qershor 2021.*

E dashur Khadija,

Me kënaqësi të veçantë mora vesh lajmin e gëzuar që Dhoma së Deputetëve e Vendeve të Ulëta, i dha dritën jeshile thirrjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare Shqipëri-BE.

Që prej takimit tonë në prill të vitit 2019 e deri më sot bashkëpunimi ynë ka ardhur duke u zgjeruar e fuqizuar.

Në emër të Kuvendit të Shqipërisë dhe në emrin tim personal, Ju shpreh mirënjohjen për shqyrtimin me kujdes të arritjeve të Shqipërisë drejt plotësimit të rekomandimeve të Komisionit dhe Këshillit Europian.

Ne asnjëherë nuk i kemi keqkuptuar rezervat e qeverisë dhe Parlamentit të Vendeve të Ulëta, por i kemi kuptuar ato si një inkurajim për të përmirësuar performancën tonë dhe për t'u bërë një vend sa më i denjë për t'u pranuar në familjen europiane. Fakti që edhe Ju, Komisioni për Çështjet Europiane dhe Dhomës së Deputetëve jeni njohur dhe i keni vlerësuar këto arritje, është një motiv më shumë që Kuvendi,

Qeveria dhe institucionet e Shqipërisë t'i shumëfishojnë përpjekjet për të vazhduar rrugëtimin tonë europian, për të arritur dhe për të qëndruar në krah të shteteve anëtare të BE-së me standarte, dinjitet dhe vlera europiane.

Shqipëria do të vazhdojë të avancojë në plotësimin e këtyre standarteve dhe do të bëhet një vlerë e shtuar e Bashkimit Europian, e kësaj familjeje të madhe politike, kulturore dhe njerëzore.

Sinqerisht,

**Gramoz RUÇI**

**Shkëlqesisë së Saj, Zonjës Khadija Arib  
Ish Presidente e Dhomës së Deputetëve, 2015-2021  
Hagë**